AKTIV

Ministry of Foreign Affairs of Denmark
DANIDA | International Development Cooperation

Schweizeriche Eidgenossenschaft
Conédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

Aktiv

Raport mbi rezultatet e hulumtimit

2018

Qëndrimet e qytetarëve në veri të Kosovës

Krijimi i një kornize të qëndrueshme për pjesëmarrje qytetare dhe vendimmarrje demokratike në institucionet lokale dhe qendrore në Kosovë

Mitrovica e Veriut

Porositësi i hulumtimit

OJQ AKTIV

Autori i hulumtimit

MA Nikollë Joviq (Nikola Jović)

Donator

Ky projekt financohet nga Programi i Zhvillimit të Shoqërisë Demokratike (DSP) i mbështetur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA), i cili zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Për botuesin

OJQ AKTIV

"Mbreti Pjetër I", nr. 183a, Mitrovica e Veriut.

email: office@ngoaktiv.org

www.ngoaktiv.org

Mitrovica e Veriut

Korrik 2018

Përmbajtja:

- Metodologjia e hulumtimit..... 3
- Rezultatet më të rëndësishme..... 4
- Përshkrimi i mostrës..... 7-9
- Rezultatet e hulumtimit.....10-48
- Konkluzionet 49-50

Metodologjia e hulumtimit

Mënyra e hulumtimit: Sondazhi në terren ballë për ballë (*F2F*)

Anketa: Pyetësori i përbërë nga 46 pyetje në kohëzgjatje prej 20 minuta

Koha e hulumtimit: 20 – 30 qershor 2018

Vendi i hulumtimit: Mitrovica e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan

Madhësia e mostrës: 800 të anketuar

Lloji i mostrës: Mostër e rastësishme e stratifikuar - stratifikimi bazuar në komunën e banimit

Gabim statistikor: 95% intervali statistikor i besimit për ndodhi me një incidencë prej 50% është **+/-** 3.2%

Nënstratifikimet: gjinia, mosha, vendbanimi dhe niveli i arsimimit

Paraqitja grafike e gjetjeve kryesore

Frekuenca e ndërveprimeve midis bashkësive etnike është në rritje, mu ashtu si perceptimi pozitiv i marrëdhënieve etnike që dalin nga ndërveprime të tilla:

15% e respodentëve vlerësojnë situatën aktuale politike në Kosovë si të mirë.

Edhe treguesit tjerë të gjendjes së marrëdhënieve etnike tregojnë një tendencë të rritjes së perceptimeve afirmative në mes të komunitetit serb dhe shqiptar në veri të Kosovës, përfshi besimin, frekuencën e ndërveprimeve, përvojat pozitive. Madje edhe matjet standarde të distancës etnike treguan një rënie të distancës nga 5.1 në 2016 në 4.6 pikë indeksi në 2018.

Mosbesimi i komunitetit në veri të Kosovës në liderët politikë mbetet i lartë. Këtë vit, 99,6% e respodentëve thanë se nuk i besojnë asnjë politikani shqiptar. Sa i përket politikanëve nga komuniteti serb, mosbesimi është në rritje. Derisa në vitin 2017, 78% e respodentëve u përgjigjën se nuk kishin besim në asnjë politikan nga komuniteti serb, këtë vit ky numër u ngrit në 88.2%.

Çdo i tretë i anketuar beson se jeta e serbëve në Kosovë do të jetë më e keqe pas tre vjetësh.

12% e respondentëve thonë se i besojnë një politikani në Kosovë. Numri i respodentëve që besojnë se serbët e Kosovës duhet të mbështeten në BE në paraqitjen e interesave të veta shënon rritje të konsiderueshme, nga 5.3% në

2017 në 13.1% në 2018. Ngjashëm, numri i qytetarëve që shikojnë BE-në në kontekst negativ është përgjysmuar nga 32% në vitin 2017 dhe shënon rënie në 16% këtë vit.

Trendi i rënies së numrit të respodentëve që ndjehen të lirë për të shprehur pikëpamjet e tyre vazhdon edhe në 2018



.

Rezultatet e hulumtimit të këtij viti tregojnë qartë një "krizë besimi" në shoqërinë e Kosovës së veriut.

- 88% e qytetarëve nuk i besojnë asnjë politikani serb

- 99% e qytetarëve nuk i besojnë asnjë politikani shqiptar

- 66% e qytetarëve nuk besojnë në pavarësinë e mediave

Çdo i treti i intervistuar (34%) konsideron se rritja e aktiviteteve të paligjshme është kërcënimi më i madh i sigurisë në veri të Kosovës, rritje prej 10% krahasuar në 2016.

Numri i të rinjve të moshës nga 18 deri 29 vjeç të cilët mendojnë në mënyrë aktive për largimin nga Kosova ka kaluar gjysmën (53%). Dy nga tre të rinj me diplomë fakulteti në mënyrë aktive mendojnë për largimin. Në komunat Zubin Potok dhe Leposaviq, si zona rurale, 4/10 e të rinjve paralajmërojnë largimin në 5 vitet e ardhshme.

Përshkrimi i mostrës

Gjinia e respondentëve:



Sa vjeç jeni?

Mosha mesatare e respondentëve është 48 vjet.

Struktura e moshës së mostrës:



Niveli i arsimit i respodentëve:



Statusi i punës së respodentëve:



Vendbanimi:


40
35
30
25
20
15
10
5
0
34.1
20.6
30.8
14.5
Mitrovicë e Veriut
Zveçan
Leposaviq
Zubin Potok

Rezultatet e hulumtimit

1. **Në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 është "shumë keq" dhe 5 "shumë mirë", vlerësoni:**

	Nota mesatare
Situatën politike në Kosovë	2,1.
Situatën e sigurisë në Kosovë	2,1.
Situatën ekonomike në Kosovë	2,1.
Situatën e juaj materiale	2,6

Krahasuar me dy vitet e kaluara, kur kemi kryer hulumtimin, mund të shohim se vlerësimet e gjendjes politike, të sigurisë, ekonomike dhe financave personale janë paksa më të larta.



Respodentët më të moshuar janë më pak të kënaqur me gjendjen aktuale në lidhje me situatën politike. Pak më shumë se 80% e respondentëve të moshës mbi 65 vjeç besojnë se situata politike është e keqe. Nga ana tjetër, numri më i vogël i atyre që konsiderojnë se situata politike është e keqe (63%) i takon grupmoshës 30-45 vjeç. Kur është fjala për situatën e sigurisë, më të rinjtë janë më së paku të kënaqur, ndërsa më të kënaqur janë më të moshuarit.

Natyra dhe dinamika e jetës janë dukshëm të ndryshme midis këtyre dy grupmoshave, prandaj nuk duhet të habitë një dallim i tillë në përjetimin e sigurisë.

Gjithashtu, hulumtimet tregojnë se arsimi ka një ndikim të veçantë në përjetimin e kënaqësisë me situatën e tyre financiare. Me rritjen e arsimit të respondentëve, rritet edhe kënaqësia e tyre me gjendjen financiare. Kënaqësia me gjendjen financiare te respondentët me shkollë fillore është vlerësuar me notë mesatare prej 1.9, ndërsa te respondentët me fakultet vlerësohet me notë mesatare 2.9.

2. Shikuar në përgjithësi, a po zhvillohen gjërat në veri të Kosovës në drejtim të mirë?



Me krahasimin e tre hulumtimeve vërejmë dallime të konsiderueshme në qëndrimet e respodentëve. Përderisa në vitin 2016, 23% e respondentëve konsideronin se gjërat në Kosovë zhvilloheshin në drejtimin e duhur, në vitin 2017 kjo përqindje ishte dukshëm më e ulët dhe ishte 6.8%. Sot, situata është disi më e mirë, por përsëri shumë negative, pasi vetëm 9.5% e respondentëve mendojnë se gjërat në Kosovë po shkojnë në drejtimin e duhur. Lëvizje të tilla të konsiderueshme në perceptimin e popullsisë shpjegohet nga ndikimi i ngjarjeve të përditshme politike në vlerësimet e respodentëve. Megjithatë, është indikative që një numër shumë i vogël i respodentëve, në tre vitet e fundit sa bëhet kjo matje, i konsideron pozitive trendët kryesore socio-politike.



3. Sipas jush, jeta për serbët në Kosovë për tre vjet do të jetë:



Optimizmi më i vogël është në mesin e respondentëve të gjeneratës më të re, nga të cilët vetëm 6% mendojnë se për tre vjet do të jenë më mirë në Kosovë. Më optimistët janë respodentët mbi moshën 66 vjeçare, prej të cilëve 18% besojnë se do të jetë më mirë pas tre vjetësh në Kosovë. Gjithashtu, ka dallime të konsiderueshme nga sondazhi i vitit 2017, kur 54% e respodentëve mendonin se situata do të ishte më e keqe pas tre vjetësh. Rezultatet e studimit të këtij viti janë të ngjashme me rezultatet e vitit 2016, kur 35% e respodentëve mendonin se jeta në Kosovë do të ishte më e keqe pas tre vjetësh. Ndryshimi i trendit në rezultatet për vitin 2018 interpretohet nga procesi i etabluar i integrimit në sistemin ligjor të Kosovës.

4. Sipas mendimit tuaj, cili është problemi më i madh në veri të Kosovës?



Grafiku i mësipërm tregon qartë se qytetarët e veriut të Kosovës e shohin situatën e paqëndrueshme politike, ekonomike dhe të sigurisë, si dhe krimin si problem kryesor. Numri i qytetarëve që e shohin krimin si një nga problemet kryesore në veri të Kosovës po shënon rritje të ndjeshme; nga 8% në 2016 dhe 11% në 2017 në 20.6% në hulumtimin e këtij viti.

Perceptimi i rritjes së shkalës së krimit si problemi më i madh në veri të Kosovës në tre vitet e fundit është rritur ndjeshëm:



5. **A i prekin problemet kryesore në Kosovë në mënyrë të barabartë serbët dhe shqiptarët?**



Nga viti në vit, përgjigjet e marra në këtë pyetje nuk ndryshojnë ndjeshëm.

6. **Sa shpesh shkoni në zonat ku shqiptarët janë shumicë?**



Respodentët nga komuna e Zveçanit shkojnë më së rralli, ndërsa më së shpeshti respodentët nga Mitrovica e Veriut shkojnë në vendet ku shqiptarët janë shumicë.

	Shkojnë
Mitrovica e Veriut	41,2%
Zubin Potok	23,7%
Leposaviq	21,4%
Zveçan	21%

Frekuenca e shkuarjes në zonat ku shqiptarët janë shumicë, është e lidhur ngushtë me nivelin e arsimimit të respodentëve. Analizat tregojnë se më së paku shkojnë respodentët me shkollë fillore (11.7%), ndërsa më së shumti respodentët me fakultet (38.2%). Gjithashtu, në mjediset ku shqiptarët janë shumicë, më së shpeshti shkojnë respodentët e moshës mesatare (30-45), ndërsa më së paku më të rinjtë dhe më të moshuarit.

Krahasuar me dy vitet e kaluara (2016 - 29%; 2017 - 25%), vërejmë se është zvogëluar numri i respodentëve që nuk shkojnë kurrë në mjedise ku shqiptarët janë shumicë (2018: 16%), derisa është rritur numri i respodentëve i cili shpesh ose shumë shpesh viziton mjediset ku shqiptarët janë shumicë, që mund të vërehet në grafikun më poshtë:



Në përgjithësi, një nga gjetjet kryesore të studimit të këtij viti është një trend pozitiv i treguesve që përshkruajnë marrëdhëniet etnike, nga frekuenca e ndërveprimit, përvojat pozitive deri te besimi. Në fokus grupet e mëvonshme dhe intervistat e bëra me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, politikëbërësit dhe popullatën lokalë, janë shtjelluar më tej arsyet për këtë

ndryshim në disa dimensione kyçe, ndër të cilat është edhe rritja e nevojave institucionale. Këtu mund të vërehet niveli i koincidencës ndërmjet asaj që mund të përshkruhet si situatë e përmirësuar e sigurisë dhe kushte të integrimit të shtuar në kornizat ligjore dhe politike të Kosovës. Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit theksuan se nuk është fjala për *besimin* në kuptimin e ngushtë të fjalës, porse është më shumë domosdoshmëria dhe bindja themelore se siguria personale nuk është shqetësim themelor, siç ishte më parë. Kur është fjala për këtë, shumë pjesëmarrës theksuan se megjithëse nuk e ndjejnë se janë të kërcënuar fizikisht kur udhëtojnë në vende me shumicë shqiptare, kjo megjithatë nuk nënkupton se ka besim të përgjithshëm në aftësinë e strukturave qeverisëse të Kosovës për të mbrojtur institucionalisht dhe me vullnet të drejtat e tyre ligjore dhe kushtetuese. Në fakt, opinionet e shprehura brenda fokus grupeve dhe intervistave kanë treguar një mungesë të konsiderueshme të *besimit institucional* te një pjesë e pjesëmarrësve, ku vërehet mbizotërimi i frikës nga diskriminimi dhe pengimi që mund të ndodhë gjatë bashkëveprimit të tyre me strukturat shtetërore. Në të njëjtën kohë, ekziston një dëshirë e rritur për të lëvizur në mjediset me shumicë shqiptare, gjë që vërehet edhe në rezultatet e anketës, si dhe gjatë kohëzgjatjes së intervistës dhe brenda fokus grupeve. Diçka që ndoshta është lënë jashtë nga anketa është çështja ekonomike si faktor në rritjen e nivelit të ndërveprimit mes serbëve dhe shqiptarëve; pjesëmarrësit theksuan se bizneset dhe llojet e tjera të punëve të ngjashme mund të kenë ndikim potencial.

7. Eksperienca e juaj nga kontakte personale me shqiptarët janë kryesisht:



Hulumtimi i këtij viti tregon se përvojat e kontakteve personale me shqiptarët në tre vitet e fundit janë bërë shumë më pozitive:



8. Vlerësoni gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike aktuale në mes të komuniteteve në Kosovë në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 është "jashtëzakonisht të këqija" dhe 5 "të shkëlqyera":

	Nota mesatare
Serbëve dhe goranëve	3,6.
Serbëve dhe boshnjakëve	3,2.
Serbëve dhe shqiptarëve	2,2.



Derisa në vitin 2016, 5% e respodentëve mendonin se marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve ishin të mira ndërsa në vitin 2017 vërejmë dyfishimin e numrit, këtë vit shohim një rritje të konsiderueshme sipas së cilës 18% e respodentëve theksojnë se marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve të këtyre dy komuniteteve janë të mira ose shumë të mira. Marrëdhëniet me goranët janë të qëndrueshme si në vitet e kaluara, ndërsa marrëdhëniet me boshnjakët po përmirësohen gjithashtu.

9. A ka ndryshuar situata ekonomike në veri të Kosovës gjatë vitit të kaluar?



Hulumtimi tregon se ekziston një ndryshim i rëndësishëm kur bëhet fjalë për perceptimin e situatës ekonomike krahasuar me hulumtimet dy vjet më parë, por jo në krahasim me vitin e kaluar. Gjegjësisht, në vitin 2016, 28% e respondentëve mendonin se situata ekonomike u përkeqësua, ndërsa në vitin 2017, rreth 46% e respodentëve mendonin se situata ekonomike u përkeqësua. Rezultatet e këtij viti tregojnë se ka rënë pak numri i atyre për të cilët gjendja ekonomike në veri të Kosovës është përkeqësuar (43%).

10. Sa shpesh ndiqni zhvillimet politike?



11. A ka politikanë në Kosovë në të cilët keni besim?



Rezultatet e hulumtimit të këtij viti tregojnë se te qytetarët është ulur ndjeshëm besimi tek politikanët. Gjegjësisht, në 2016, 19% e respondentëve kishin besim tek një politikan, ndërsa në 2017 madje 23%. Këtë vit ky numër është përgjysmuar në mënyrë aritmetike, gjë që na tregon se ka pasur një erozion të besimit tek politikanët në Kosovë.

Hulumtimi i këtij viti tregon se me rritjen e kufirit të moshës rritet besimi tek politikanët:

	Kam besim
18-29	6,7%
30-45	11%
46-65	11,7%
66 e më shumë	17,6%

Përveç kësaj, sa i përket besimit, ka dallime në mes të banorëve të vendeve të ndryshme në veri të Kosovës:

	Kam besim
Mitrovica e Veriut	5,7%
Zubin Potok	27%
Leposaviq	11,8%
Zveçan	11,7%

12. Cilit politikan serb në Kosovë i besoni më së shumti?



Krahasuar me vitin 2017, kur 78.1% e respodentëve u përgjigjën se nuk kishin besim në asnjë politikan, ky numër madje është ngritur në 88.2%. Emrat që u gjetën në këtë tabelë u shënuan nga vetë qytetarët, sepse pyetësori kishte mundësinë për një gjë të tillë.

13. Cilit politikan shqiptar në Kosovë i besoni më së shumti?



Ngjashëm me pyetjen e mëparshme, respodentët vetë shënuan emrat e paraqitura në këtë tabelë. Përqindja e respodentëve që nuk besojnë asnjë politikani shqiptar këtë vit, ngjashëm me të mëparshmit, është në 99.6 për qind shumë të mëdha.

14. Serbët nga Kosova në politikën e jashtme dhe lobim kryesisht duhet të mbështeten në:



Ndërsa hulumtimi i vitit 2016 tregoi se 17% e respodentëve mendonin se në lobimin për interesat e serbëve në Kosovë duhet të mbështeten në BE, vitin

tjetër kjo përqindje ka rënë ndjeshëm, kështu që në vitin 2017 vetëm 5% e respodentëve mendonin se në politikën e jashtme duhet të mbështetemi më shumë në BE-në. Hulumtimi i këtij viti tregon se BE-ja, si akter potencial për lobim afërsisht po kthehet në nivelin para dy vjetëve.

Nga ana tjetër, numri i respodentëve që besojnë se serbët e Kosovës në përfaqësim për arritjet e qëllimeve të tyre duhet të mbështeten në Rusinë shënon rënie të vazhdueshme, nga 75% (2016), 64% (2017) në 51% në vitin 2018.

15. A keni dokumente personale të lëshuara nga institucionet e Kosovës?



Përqindja e qytetarëve që posedojnë dokumente personale të lëshuara nga autoritetet e Kosovës është në rritje. Anketa tregon se në tre vjet numri i respodentëve që kanë dokumente të lëshuara nga institucionet e Kosovës është rritur për 5%. Sipas respodentëve nga fokus grupet, ky trend është pasojë e presionit të ushtruar nga komuniteti që më parë e konsideronte një veprim të tillë si tradhti e interesit të serbëve në Kosovë. Përveç kësaj, ky trend shpjegohet me progresin në integrimin e veriut në sistemin administrativ-juridik të Kosovës.

16. A keni përdorur shërbimet e institucioneve të Kosovës?



Krahasuar me dy hulumtimet e mëparshme, nga 2016 dhe 2017, mund të shohim se numri i atyre që përdorin shërbimet e institucioneve të Kosovës është rritur për gati 20%. Rezultati është komplementuar me rezultatet e pyetjes së mëparshme, me të cilin është konstatuar rritja e numrit të qytetarëve të veriut të Kosovës të cilët posedojnë dokumente të lëshuara nga institucionet e Kosovës.

Hulumtimi tregon se respodentët më të moshuar përdorin më së shumti shërbimet e institucioneve të Kosovës, ndërsa të rinjtë më së paku. Përveç kësaj, më të moshuarit janë më të kënaqurit me shërbimet, madje 61% e respodentëve më të vjetër se 65 vjeç kanë thënë se janë të kënaqur me shërbimet.

Hulumtimi gjithashtu tregon një dallim të rëndësishëm sipas komunave:

	Kam përdorur shërbimet e institucioneve të Kosovës
Mitrovica e Veriut	68%
Zubin Potok	58,4%
Leposaviq	68,2%
Zveçan	71,6%

Krahasuar me dy hulumtimet e mëparshme, nga 2016 dhe 2017, mund të shohim se numri i atyre që përdorin shërbimet e institucioneve të Kosovës është rritur për gati 20%.



17. Në një shkallë prej 1 deri në 5, vlerësoni sa jeni të kënaqur me efiçiencën e institucioneve të mëposhtme:

Qeveria e Serbisë	2,9.
Zyra për Kosovë e Metohi	2,9.
Katër komuna të sapoformuara të Kosovës në veri	2,8.
Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale	2,5.
Deputetët serb në Kuvendin e Kosovës	2,5.
Ministrat serb në Qeverinë e Kosovës	2,4.
KFOR	2,3.
UNMIK	2,2.
Policia e Kosovës	2,1.
Zyra e BE-së në Kosovë	2,1.

EULEX	2,1.
Qeveria e Kosovës	2,1.

18. **Në një shkallë prej 1 deri në 5, vlerësoni sa i besoni institucioneve të mëposhtme:**

Zyra për Kosovë e Metohi	2,9.
Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale	2,9.
Qeveria e Serbisë	2,8.
Katër komuna të sapoformuara të Kosovës në veri	2,8.
Deputetët serb në Kuvendin e Kosovës	2,4.
Ministrat serb në Qeverinë e Kosovës	2,3.
KFOR	2,3.
UNMIK	2,3.
Policia e Kosovës	2,2.
Zyra e BE-së në Kosovë	2,2.
EULEX	2,1.
Qeveria e Kosovës	2,1.

Rezultatet nga dy tabelat e mëparshme janë kryesisht identike me rezultatet e arritura në vitet e mëparshme andaj nuk janë vërejtur ndryshime të rëndësishme në qëndrimin e qytetarëve ndaj institucioneve të përmendura.

19. Cili është qëndrimi juaj ndaj Marrëveshjes së Brukselit?



Qëndrimi i qytetarëve ndaj Marrëveshjes së Brukselit nuk ka ndryshuar ndjeshëm gjatë tre viteve të fundit.

Duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, vërejmë se ka ngjashmëri të konsiderueshme midis grupit më të ri dhe më të moshuar të respodentëve:

	E mbështes
18-29 vjeç	9,8%
30-45 vjeç	22,6%
45-65 vjeç	17,4%
66+ vjeç	9,8%

Analizat gjithashtu tregojnë se ka dallime të konsiderueshme në mbështetje të Marrëveshjes së Brukselit ndërmjet respondentëve nga komunat e ndryshme:

	E mbështes
Mitrovica e Veriut	20,5%
Zubin Potok	17,5%
Leposaviq	9,5%
Zveçan	16,7%

20. A ka ndryshuar jeta e serbëve në Kosovë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit?



Në hulumtimin në vitin 2016, 25% e respodentëve theksuan se jeta e serbëve në Kosovë u përkeqësua pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, ndërsa në vitin 2017 numri i respodentëve me këtë qëndrim u rrit ndjeshëm në 42% dhe mbeti i pandryshuar edhe këtë vit pa dallime të rëndësishme.

21. Cili është qëndrimi juaj ndaj pjesëmarrjes së serbëve në institucionet e Kosovës?



Qëndrimi në lidhje me pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës nuk ka ndryshuar ndjeshëm gjatë tre viteve të fundit.

Numri i respodentëve që mbështesin pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës dallon nga komuna në komunë:

	E mbështes
Mitrovica e Veriut	35,3%
Zubin Potok	21,1%
Leposaviq	15,8%
Zveçan	24,2%

Numri i respodentëve që mbështesin pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës dallon varësisht nga niveli i arsimit:

	E mbështes
Fillor	11,7%
I mesëm	24,6%
I lartë	22%
Më i lartë/Universitar	34,7%

22. A do të dilni në zgjedhjet e ardhshme të Kosovës kur ato të mbahen?



Gjatë tre viteve të fundit ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të respodentëve që planifikojnë të dalin në zgjedhjet e ardhshme në Kosovë. Derisa në vitin 2016, kjo shifër ishte rreth 26% e në vitin 2017 36%, sipas të dhënave nga sondazhi i këtij viti, 45% e respodentëve planifikojnë të dalin në zgjedhjet e ardhshme të Kosovës, një rritje prej gati 20% në dy vjet.

Numri i respodentëve që planifikojnë të dalin në zgjedhjet e ardhshme në Kosovë dallon sipas moshës së respodentëve:

	Sigurisht/sipas të gjitha gjasave do të votoj
18-29	35,1%
30-45	45,8%
46-65	49,2%
66 e më shumë	43,9%

Numri i respodentëve që planifikojnë të dalin në zgjedhjet e ardhshme në Kosovë dallon sipas nivelit të arsimit të respodentëve:

	Sigurisht/sipas të gjitha gjasave do të votoj
Fillor	27,3%
I mesëm	45,6%
I lartë	49,1%
Më i lartë/Universitar	46,6%

Numri i respodentëve që planifikojnë të dalin në zgjedhjet e ardhshme në Kosovë dallon nga komuna në komunë:

	Sigurisht/sipas të gjitha gjasave do të votoj
Mitrovica e Veriut	46,9%
Zubin Potok	57,1%
Leposaviq	37,6%
Zveçan	45%



23. Çfarë mendoni, a do të formohet Asociacioni i komunave të serbe?



Ne tri vitet e fundit nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme kur bëhet fjalë për numrin e njerëzve që besojnë se do të formohet Asociacioni i komunave serbe.

24. Në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë "nuk pajtohem plotësisht" dhe 5 "pajtohem plotësisht", si do të vlerësonit qëndrimet e mëposhtme për Asociacioni i komunave serbe?

	Nota mesatare
AKS do të kontribuojë në përmirësimin e pozitës së serbëve në Kosovë	2,7.
AKS do të kontribuojë në integrimin e serbëve në sistemin ligjor-politik të Kosovës	2,7.
AKS do të mundësojë zhvillimin ekonomik dhe punësimin	2,6.



Ndërsa te shumica e respodentëve ka optimizëm lidhur me formimin e AKS-së, në tre vitet e fundit është shënuar një rritje e lehtë e pesimizmit kur flasim për perceptimin e qytetarëve se çfarë do t'i sjellë Asociacioni i komunave serbe, nëse dhe kur formohet.

.

25. Në shkallën nga 1 deri në 5, ku 1 është "aspak fare" dhe 5 "plotësisht", a do të përmirësojë Asociacioni i komunave serbe jetën e:

	Nota mesatare
Serbëve në veri të Kosovës	2,7.
Shqiptarëve në veri të Kosovës	2,6.
Serbëve në jug të Ibrit	2,5.
Komuniteteve të tjera në Kosovë	2,5.



Sikurse në pyetjen e mëparshme, hulumtimi i këtij viti tregon se në lidhje me hulumtimet e vitit 2016 dhe 2017 ka pasur një rënie në pritjet për përfitimet që mund të sjellë themelimi i Asociacionit të komunave serbe.

26. Mbi çfarë bazash krijoni qëndrimet për politikat dhe ngjarjet politike?



Mediat mbeten burimi kryesor i informacionit për qytetarët që kanë ndikim kryesor në formimin e qëndrimeve të tyre politike. Vazhdimësia në rezultatet nga viti në vit ekziston edhe në çështjen e besimit në media. Gjithsej 37% e respodentëve besojnë ose plotësisht besojnë mediave në Beograd, ndërsa

sipas të njëjtit kriter, 22% e respodentëve besojnë mediave serbe në Kosovë, ndërsa më pak se 15% mediave shqiptare nga Kosova.



27. Në një shkallë prej 1 deri në 5, ku 1 do të thotë "nuk i besoj aspak" dhe 5 "besoj plotësisht", sa besoni:

	Nota mesatare
mediave serbe nga Beogradi	2,9.
mediave serbe në Kosovë	2,6.
mediave shqiptare	1,5.



28. A janë të prezantuara sa duhet në media në Kosovë qëndrimet e pavarura dhe të menduarit kritik?



Numri i qytetarëve (respodentëve) që besojnë se qëndrimet e pavarura dhe të menduarit kritik nuk janë të përfaqësuara në media, po ngritët çdo herë, nga 53% në 2016 dhe 2017, është rritur në 66% këtë vit. Kur kësaj i shtohen rezultatet e mosbesimit të qytetarëve të politikanëve dhe institucioneve, lirisht mund të flitet për "krizën e besimit" në shoqëri në veri të Kosovës.

29. A ndiheni të lirë të shprehni publikisht qëndrimet e juaja politike?



Nga viti në vit ekziston një trend i përhapjes së frikës tek respodentët për të shprehur lirshëm qëndrimet e tyre politike:



Krahasuar me dy hulumtimet e mëparshme, shohim se ka një trend të përhapjes së frikës midis respodentëve për të shprehur lirshëm qëndrimet e tyre politike. Dy vjet më parë, 48% e respodentëve theksuan se kishin frikë të shprehnin publikisht qëndrimet e tyre dhe të flasin lirshëm për politikën, vitin e kaluar përqindja u rrit në 64%, ndërsa këtë vit ka edhe më shumë qytetarë të frikësuar, madje 78%.



Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit dhe intervistave në veri të Kosovës theksuan një rritje të ndjeshme të tensioneve në nivel lokal, që rrjedhin nga ndikimi i ngjarjeve të fundit politike[1]. Në disa raste është theksuar se pluralizmi brenda kontekstit të sistemit politik serb nuk është zvogëluar aspak në kushtet e dominimit në rritje të Partisë Progresive Serbe (SNS), të Aleksandër Vuçiqit dhe Listës Serbe. Si pasojë e kësaj, ekziston një frikë mbizotëruese dhe përmbajtje nga shprehja e një mendimi që do të ishte në kundërshtim me 'linjën e partisë'. Ndikimi i ushtruar ne institucionet dhe autoritetet nga ana e anëtarëve të partisë në pushtet është i gjerë, ku kërcënimet për humbjen e punës dhe format e tjera të kërcënimit janë të mjaftueshme për të shtypur dialogun më të hapur politik. Pjesëmarrësit gjithashtu theksuan se vrasja e fundit e Olliver Ivanoviqit dhe incidentet tjera janë tregues i rritjes së polarizimit, si dhe hapësirës së kufizuar publike.

30. A ishte rrezikuar siguria e juaj ose e familjes tuaj të ngushtë gjatë gjashtë muajve të fundit?



Krahasuar me dy vitet e kaluara (2016 13%; 2017 14%), shohim se ka pasur rritje të rrezikimit të sigurisë personale. Këto rezultate i atribuohen një sërë incidentesh që ndodhën në zonat serbe në Kosovë gjatë anketimit të qytetarëve.

Perceptimi i rrezikshmërisë së sigurisë personale varion nga komuna në komunë:

[1]Ngjarjet e dhëna në mënyrë të konsiderueshme dhe të drejtpërdrejtë ndikuan në tonin dhe formën e dialogut social dhe diskursit.

	Siguria personale e rrezikuar
Mitrovica e Veriut	32,3%
Zubin Potok	9,6%
Leposaviq	5,8%
Zveçan	24,6%

31. A ka ndryshuar situata e sigurisë në veri të Kosovës gjatë vitit të kaluar?



Nuk ka lëvizje të rëndësishme ndërmjet 2017, kur 52% e respodentëve theksuan se kishte një përkeqësim të situatës së sigurisë në vitin 2018, kur ky numër ishte paksa nën 50%.

32. Sipas mendimit tuaj, cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë në mjedisin tuaj?



Kur bëhet fjalë për perceptimin e rreziqeve më të mëdha të sigurisë, mund të shohim se ka pasur një frikë të shtuar midis qytetarëve nga rritja e aktiviteteve ilegale (madje 12% krahasuar me vitin e kaluar) dhe zvogëlimin e frikës nga incidentet ndëretnike (për 10% krahasuar me vitin e kaluar). Është interesante se perceptimi i paqëndrueshmërisë politike, si një rrezik sigurie nuk ka ndryshuar aspak në tre vitet e fundit.

Bazuar në rezultatet empirike të anketës, si dhe në kërkimin shtesë të cilësisë, mund të konkludojmë se gjatë vitit të kaluar ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në perceptimin e sigurisë fizike dhe materiale në veri të Kosovës. Kjo është kryesisht, por jo vetëm, pasojë e rritjes së aktiviteteve të paligjshme[2]. Në përgjithësi, 34.2% e respodentëve theksuan se aktivitetet ilegale janë në të vërtetë kërcënimi më i madh për komunitetet e tyre, që është një rritje prej 10% krahasuar me hulumtimin e vitit të kaluar. Kjo mund t'i atribuohet një numri të incidenteve specifike që ndodhën; gjegjësisht, vrasja e politikanit kosovar, serbit, Olliver Ivanoviq, si dhe një besim i përhapur se hetimi i vrasjes së Ivanoviqit nuk do të japë rezultate konkrete apo prova[3], gjë që krijoi paqartësi rreth ngjarjes. Mungesa e perceptuar e transparencës në pjesën e elitës politike në kombinim me ndjenjën mbizotëruese të pasigurisë dhe besimi se rritja e aktiviteteve ilegale mbizotëron në veri të Kosovës ka krijuar në përgjithësi një numër shqetësimesh rreth statusit të ardhshëm të institucioneve serbe, zhvillimit të politikës dhe sigurisë fizike.

33. Si do të ndikojë hapja e mundshme e urës kryesore mbi Ibër në situatën e sigurisë?



[2]Nga deklaratat e pjesëmarrësve të marra gjatë kohëzgjatjes së fokus grupeve të mbajtura në Mitrovicën e Veriut më 18 dhe 19 qershor 2018.

[3] http://www.balkaninsight.com/en/article/serbia-kosovo-lack-cooperation-in-ivanovic-murder-investigation-05-30-2018

34. Në një shkallë prej një deri në pesë, vlerësoni se deri në çfarë mase Marrëveshja e Brukselit ka avancuar liritë dhe të drejtat e popullit serb në Kosovë?



Krahasimi i rezultateve të hulumtimit në tre vitet e fundit tregon se respodentët konsiderojnë se mbrojtja e lirive dhe të drejtave të popullit serb në Kosovë në dritën e Marrëveshjes së Brukselit po përkeqësohet çdo vit. Krahasuar me vitin 2016, kur 35% e respodentëve konsideruan se Marrëveshja e Brukselit nuk përmirësoi mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të popullit serb në Kosovë, në vitin 2018 kjo shifër ishte dukshëm më e lartë, duke arritur në 51%.

35. Vlerësoni respektimin e të drejtave dhe lirive në vijim të popullit serb në komunat veriore?

E drejta në gjuhë	4,1.
E drejta në arsim	4,1.
E drejta në lirinë e fesë	4.
E drejta në lirinë e shprehjes së kombësisë	3,7.
E drejta në kujdes shëndetësor	3,6.

E drejta në lëvizje të lirë	3,6.
E drejta në lirinë e shprehjes	3,3.
E drejta në punësim	2,8.

36. A e shihni veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme?



Krahasuar me studimin e vitit të kaluar, frekuenca e përgjigjes për këtë pyetje ka mbetur pothuajse identike. Megjithatë, ajo që ka ndryshuar është fakti se ndjeshëm është rritur numri i respodentëve më të rinj të cilët aktivisht planifikojnë të largohen nga Kosova. Përderisa vitin e kaluar çdo respodent i tretë i gjeneratës më të re mendonte për këtë, këtë vit çdo respodent i dytë i moshës 18-29 vjeç nuk e sheh veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme. Përveç kësaj, është edhe më e rëndësishme të theksohet se dy të tretat e respodentëve me diplomë universiteti planifikojnë të largohen nga Kosova.



Përveç kësaj, është më e rëndësishme të theksohet se çdo i dyti respodent me arsim universitar planifikon të largohet nga Kosova.

Analizat tregojnë se ekziston një dallim në planet jetësore mes respodentëve nga komunat e ndryshme kur bëhet fjalë për qëndrimin ose largimin nga Kosova:

	Nuk e shoh veten në Kosovë pas 5 vjetësh
Mitrovica e Veriut	53%
Zubin Potok	80%
Leposaviq	77,2%
Zveçan	59,7%

37. A u largua dikush nga rrethi i juaj i ngushtë në Kosovë gjatë 6 muajve të fundit?



Një analizë krahasuese e përgjigjes për këtë pyetje në tre vitet e fundit tregon një rritje të ndjeshme:



38. Kur dëgjoni "Bashkim Evropian", a është asociacioni i parë pozitiv apo negativ?



Asociacioni negativ ndaj BE-së ka rënë për rreth 16% krahasuar me hulumtimin e vitit të kaluar dhe rreth 7% në lidhje me hulumtimin e vitit 2016.

Vetëm 12% e respodentëve të rinj kanë një asociim pozitiv me Bashkimin Evropian. Kur bëhet fjalë për grupmoshat e tjera, as në sytë e tyre Bashkimi Evropian nuk është i pozicionuar më mirë:

	Asociim pozitiv
18-29	12,8%
30-45	25,3%
46-65	14%
66 e më shumë	14,6%

Niveli i arsimit gjithashtu tregon dallime të konsiderueshme në perceptimin e Bashkimit Evropian:

	Asociim pozitiv
Fillor	10,4%
I mesëm	19,9%
I lartë	11,1%
Më i lartë/Universitar	17,5%

39. Kur prisni që Kosova të anëtarësohet në BE?



Gjatë tre viteve të fundit, pesimizmi është rritur ndjeshëm kur bëhet fjalë për anëtarësimin e ardhshëm të Kosovës në Bashkimin Evropian. Ndërsa në vitin 2016, 44% e respodentëve konsideronin se Kosova do të anëtarësohej në BE, ndërsa në vitin 2017 kjo përqindje tashmë kishte rënë në 33%, e këtë vit është 22%.

40. Si e shihni pozitën e Bashkimit Evropian në procesin e negociatave ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës?



Vit pas viti, ka një trend në rritje të numrit të respondentëve të cilët e shohin rolin e BE-së në procesin negociator midis Beogradit dhe Prishtinës si neutral. Gjegjësisht, në vitin 2016 kjo përqindje ishte 13%, në 2017 21%, ndërsa këtë vit është 27%.

41. Çfarë ndikimi do të kishte anëtarësimi i Kosovës në BE në juve personalisht?



42. Në çfarë mënyre do të ndryshonte anëtarësimi i Kosovës në Bashkimin Evropian gjendja ekzistuese socio-ekonomike në Kosovë?



43. A e përkrahni anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian?



44. Në një shkallë prej 1 deri në 5 ku 1 "plotësisht nuk pajtohem" dhe 5 "plotësisht pajtohem", vlerësoni vërtetësinë e pohimeve të mëposhtme:

	Nota mesatare
BE luan rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb në Kosovë	2,2.
BE luan rol kyç në pajtimin ndëretnik në Kosovë	2,1.
BE investon mjaftueshëm në veri të Kosovës	2,1.
Po të ishte Kosova anëtare e BE-së, të drejtat e komunitetit serb do të ishin më të mbrojtura	1,9.



Derisa përgjigjet në dy pretendimet e fundit nuk kanë ndryshuar në tre vitet e fundit, vërehet se besimi në BE si akter kyç në zgjidhjen e problemit të komunitetit serb në Kosovë (2016). – 2.7; 2017. – 2.6; 2018. - 2.2) dhe pajtimit ndëretnik në Kosovë (2016. – 2.5; 2017. – 2.5; 2018. - 2.1) zvogëlohet ndjeshëm.

45. Matja e distancës etnike

A do ta prananit që një pjesëtar/e i përkatësisë etnike shqiptare:



Shkalla e distancës etnike *(total)*

Ne i ndamë të gjithë respodentët në katër grupe: ata që nuk kanë distancë (0 përgjigje negative), ata me një distancë të vogël (1-2 përgjigje negative), një distancë të moderuar (3-5 përgjigje negative) dhe distancë të theksuar (6-7 përgjigje negative). Bazuar në këtë kemi marrë të dhënat e mëposhtme:



Hulumtimi tregon se distanca etnike është zvogëluar nga hulumtimi e mëparshëm që ndodhi një vit më parë. Vitin e kaluar, distanca etnike në shkallën nga 0 në 7 ishte 5.1, ndërsa ky vit është përafërsisht në nivelin 2016 dhe është 4.6. Këto rezultate janë në përputhje me konkluzionet e përgjithshme të

këtij hulumtimi, që është se marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë tregojnë një trend pozitiv.

Niveli i arsimimit të respodentëve luan një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e përgjigjeve në shkallën e distancës etnike:

	Distanca e mesme dhe e madhe etnike
Fillor	77,3%
I mesëm	83,8%
I lartë	89,5%
Më i lartë/Universitar	70,9%

Parametrat në shkallën e distancës etnike ndryshojnë varësisht nga vendi i banimit:

	Distanca etnike e mesme dhe e madhe
Mitrovica e Veriut	67,5%
Zubin Potok	85,2%
Leposaviq	89,1%
Zveçan	88,6%

Frekuenca e vizitave të komuniteteve ku shqiptarët janë shumicë ndikojnë ndjeshëm në distancën etnike:

Sa shpesh vizitoni komunitetet e banuara nga shqiptarët	Distanca etnike e mesme dhe e madhe
Asnjëherë	94,4%
Shumë e rrallë	83,1%
Shpesh	72,7%
Shumë shpesh	53,5%

Këtë e tregon edhe një test korrelacioni me një korrelacion negativ të r = - 0.3, që na tregon se me vizitat e shpeshta në vendet ku jetojnë shqiptarët si shumicë ka një zvogëlim në distancën etnike. Natyrisht, për aq sa këto përvoja nga kontakti janë më pozitive, distanca është më e vogël. Çdo respodent i tretë i cili kishte një përvojë pozitive, nuk ka kurrfarë ose vetëm një distancë të vogël etnike.

Konkluzionet

Pas tre viteve të hulumtimit të opinionit publik në veri të Kosovës, mund të konkludojmë se ka çështje dhe pyetje rreth të cilave qëndrimi i qytetarëve ka ndryshuar ndjeshëm, por gjithashtu ka çështje rreth të cilave qytetarët kanë një qëndrim pothuajse të pandryshuar që nga hulumtimi i parë në 2016. Vitet e mëparshme janë vërejtur ndryshime të rëndësishme në opinionin publik, së bashku me një numër të caktuar rezultatesh të cilët në shikim janë në kundërshtim me natyrën. Ka disa ndryshime në opinionin publik që janë qartazi negative; gjithashtu vërehet një rënie e konsiderueshme statistikore në numrin e respodentëve që pretendojnë të ndjehen të lirë të shprehin opinionet e tyre në publik (nga 48% në 2016, në 22% në 2018), një numër i madh (90%) të atyre që mendojnë se gjërat në Kosovë po lëvizin në drejtim negativ, si dhe rritje të ndjeshme midis njerëzve që pretendojnë se aktivitetet e paligjshme janë problemi më i madh me të cilin ballafaqohen komunitetet lokale (8.7% në 2016 dhe 20.6% në 2018). Kjo tregon një nivel të lartë të shqetësimit në komunitetet lokale në lidhje me zhvillimet e fundit politike dhe shtrohet pyetja se deri në çfarë mase popullata lokalë sheh një të ardhme të qëndrueshme për veten e tyre në Kosovë.

Qytetarët ishin dhe mbesin shumë të pakënaqur me situatën politike, ekonomike dhe të sigurisë në Kosovë. Pavarësisht nga dinamika e theksuar dhe ndryshueshmëria e kontekstit në të cilin jetojnë nga viti 2016, kur u krye hulumtimi i parë, respodentët vlerësojnë si shumë të keqe situatën politike, ekonomike dhe të sigurisë. Edhe pse ekzistojnë përpjekje të vërteta ose të pavërteta për të përmirësuar pozicionin e serbëve në Kosovë, si nga Qeveria në Beograd ashtu edhe Qeveria në Prishtinë, hulumtimi në të vërtet tregon se qytetarët nuk ndjejnë përmirësimin.

Situata politike, ekonomike dhe e sigurisë është vetëm një manifestim i joefikasitetit të institucioneve për të vendosur një rend të duhur. Respodentët vit pas viti tregojnë shumë pak besim në institucionet, jo vetëm në ato të Kosovës por edhe serbe. Përveç kësaj, shumë është i vogël numri i respodentëve që i besojnë elitave politike. Është e vështirë të imagjinohet një komunitet i qëndrueshëm politik në të cilin qytetarët nuk kanë besim në politikë, proceset politike, institucione dhe akterë. Hulumtimi na tregon se ky trend i mosbesimit është i pranishëm pa marrë parasysh se çfarë ndryshimesh kanë ndodhur në sferën e politikës. A u nënshkrua marrëveshja e Brukselit, a kanë hyrë deputetët serbë në Qeverinë e Kosovës, si janë zhvilluar negociatat ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, e kështu me radhë. Ajo çfarë në të vërtetë është e dukshme është se format e ndryshme të "imponimit të butë" dhe

"arkitektura e veçantë e zgjedhjeve" çojnë në rritjen e numrit të qytetarëve që shfrytëzojnë shërbimet e institucioneve të Kosovës nga viti në vit. Meqenëse besimi në këto institucione nuk ndryshon nga viti në vit, ka të ngjarë që ky vendim të jetë pasojë e kontekstit dhe kufizimeve të ndryshme që sjell mospërdorimi i tyre.

Qasja më e rëndësishme në këtë kontekst vjen nga trendi i analizës së përgjigjeve në dy pyetje: *A keni votuar në zgjedhjet e kaluara të Kosovës?* dhe *A do të votoni në të ardhshmet?* Analiza e përgjigjeve tregon se nga viti në vit rritet numri i respodentëve që vendosin të marrin pjesë në zgjedhjet në Kosovë. Ky trend është një tregues i rëndësishëm ku serbët nga veriu i Kosovës mendojnë se po merren vendime për të cilat ata janë të interesuar. Përveç kësaj, marrëdhëniet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës u japin atyre një dritë të gjelbër për të marrë pjesë në mekanizmin pjesëmarrës më të rëndësishëm demokratik të një komuniteti politik.

Nga ana tjetër, ndërsa besimi tek institucionet dhe akterët politikë bie, mund të shohim se besimi ndëretnik midis serbëve dhe shqiptarëve po rritet. Kjo reflektohet edhe në kontaktet më të shpeshta, si dhe në përvojat pozitive nga ato kontakte. Prandaj, nuk duhet të jetë befasuese që distanca etnike në shkallën e Bogardusit të distancës sociale tregon një trend të rritjes së besimit ndëretnik.

Në fund, përshtypja e hulumtimit është se ekzistojnë çështjet themelore rreth të cilave qytetarët nuk kanë qëndrim, siç është qëndrimi ndaj Marrëveshjes së Brukselit. Ky informacion na alarmon nga dy kënde të ndryshme: (1) qytetarët nuk janë mjaft të informuar se mund të kenë një qëndrim të ndërtuar; (2) qytetarët kanë frikë të flasin hapur për çështje themelore, madje edhe në hulumtim të anonimizuar me anketë. Cilado qoftë arsyeja për këto dy, imponohet çështja e përgjegjësisë së elitës politike. A është ajo që përmes informimit selektiv i pengon qytetarët të kenë informacion të mjaftueshëm dhe njohuri për gjërat që janë thelbësore për jetën e tyre. Kur është fjala për frikën për të folur hapur për çështjet politike të kontestueshme, ajo gjenerohet askund tjetër përveç në arenën politike. Frika e qytetarëve për të diskutuar hapur çështjet kryesore nga viti në vit po bëhet më e pranishme gjithnjë. Pa dialog të hapur dhe liri të shprehjes së mendimit, madje edhe mospajtimit të hapur të qytetarëve, elitat politike kanë rrugën e hapur për të marrë vendime autoritative pa asnjë kontroll nga ata jeta e të cilëve është në lojë.

Autor i hulumtimit *Nikollë Joviq*



Ky projekt është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

AKTIV

Ministry of Foreign Affairs of Denmark
DANIDA | International Development Cooperation

Schweizeriche Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo